



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Prishtinës
Pristina Obstina-Municipality of Pristina



SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61 paragrafi 61.3. lidhur me nenin 63 paragrafin 63.1 nënparagrafin 63.1.1. pikën a) si dhe lidhur me nenin 62 paragrafin 1 nënparagrafin d) të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik N.T.SH. "DELFINA" të datës 26.05.2023 kundër njoftimit mbi vendimin e datës 24.05.2023 të autoritetit kontraktues lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Furnizim me inventar shkollor për artikuj që nuk janë me AQP-në - Rivlerësim" me nr. të prokurimit 616-23-1251-1-2-1, Komuna e Prishtinës (autoriteti kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **REFUZOHET** kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik N.T.SH. "DELFINA" dt. 26.05.2023 kundër njoftimit mbi vendimin dt. 24.05.2023 të autoritetit kontraktues për aktivitetin e prokurimit me titull "Furnizim me inventar shkollor për artikuj që nuk janë me AQP-në - Rivlerësim" me nr. të prokurimit 616-23-1251-1-2-1.
- II. **AUTORIZOHET** autoriteti kontraktues - Komuna e Prishtinës që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit të përcaktuar në pikën I të këtij vendimi.
- III. **NJOFTOHET** operatori ekonomik N.T.SH. "DELFINA" si dhe të gjitha palët tjera të interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Operatori ekonomik N.T.SH. "DELFINA" (tutje "parashtruesi) me datë 26.05.2023 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit mbi vendimin e datës 24.05.2023 të autoritetit kontraktues lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Furnizim me inventar shkollor për artikuj që nuk janë me AQP-në - Rivlerësim" me nr. të prokurimit 616-23-1251-1-2-1. Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Prandaj janë plotësuar kushtet për shqyrtimin meritor (*in meritum*) të kërkesës.

Faqe 1 nga 4

Pretendimet e parashtruesit janë cituar si në vijim:

- I. **Pretendimi i parë** – *“me kërkesën e datës 25.05.2023, është kërkuar qasje e plotë në dosjen dhe tërheqjen e dokumentave për dy operatorët ekonomik me çmimin më të lirë, mirëpo po të njëjten ditë AK përmes emailit thekson se OE fituese ka kërkuar që referencat të mbeten si sekrete afariste, kurse dokumentat e tjerë mund të ofrohen”.*
- II. **Pretendimi i dytë** – *“Kemi aneksin 6 deklarata për themelimin e grupit në mes të TIC LOG sh.p.k dhe EXPEDIO sh.p.k, nga çertifikata me numër serik 10065915 konstatohet se emri i biznesit është Expedio Pr & Communications Solutions sh.p.k, kurse nga çertifikata e biznesit me numër serik 10084135 kemi emrin e biznesit Expedio sh.p.k, që nuk është e qartë se a është një firmë-subjekt afarist apo dy të tilla”.*
- III. **Pretendimi i tretë** – *“OE fitues për shkak se i njëjti nuk ka paraqitur deklaratën me të cilin identifikohet nënkontraktuesi i zgjedhur për aktivitetin relevant të prokurimit, kurse në anën tjetër janë paraqitur çertifikata ISO në emër të një firme tjetër kinse prodhuese, që nuk është në nënkotratkim e që kjo është shkelje”.*

Për shkak të pretendimeve si më sipër, parashtruesi konsideron se autoriteti kontraktues në këtë aktivitet të prokurimit ka vepruar në kundërshtim me nenin 10, 11, 58, 68, 69, dhe 108/A të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik (tutje “LPP”), pastaj nenin 36 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e LPP si dhe nenin 7 par. 7.5 të Rregullores nr 001/2022 për prokurimin publik (tutje “RRPP”).

Autoriteti Kontraktues – Komuna e Prishtinës përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit me datë 31.05.2023 ka trajtuar kërkesën e parashtruesit për rishqyrtim.

Lidhur me pretendimin e parë (I) fillimisht duhet cekur që sipas nenit 1 paragrafit 12 të LPP përcaktohet se informacioni sekrete afariste është *“informacioni i përcaktuar me nenin 11 të këtij ligji”*. Tutje përmes nenit 11 paragrafit 3 të LPP është përcaktuar sikurse në vijim *“3. Autoriteti kontraktues mund t’i klasifikojë informatat e tjera si informatë sekrete afariste vetëm nëse informata përkatëse i përmbushë këto tri kritere:*

- 3.1. *që atë ta ketë dërguar një operator ekonomik në përputhje me kërkesën e përcaktuar nga autoriteti i tillë kontraktues sipas nenit 68 ose 69 të këtij ligji;*
- 3.2. *që operatori përkatës ekonomik t’i ketë dërguar autoritetit kontraktues kërkesën me shkrim duke shprehur dëshirën e tij që autoriteti kontraktues t’i mbajë artikujt e tillë si sekret; dhe*
- 3.3. *kërkesa e tillë me shkrim të përmbajë një deklaratë me shkrim (i) në të cilën vërtetohet se një element i tillë nuk është pronë publike, dhe se të dhënat mbrohen nga operatori ekonomik nga zbulimi i qëllimshëm ose nga pakujdesia, dhe (ii) me të cilin parashtruesi arsyet, që bindshëm demonstron, sipas gjykimit të arsyeshëm të autoritetit kontraktues, se qasja publike në elementin e tillë do të rezultonte në dëmtimin material të interesave legjitime komerciale të operatorit të tillë ekonomik”.*

Në rastin konkret sa i përket nenit 11 par. 3 nënpar. 1, nuk është fare kontestuese që dokumentet e klasifikuara si sekrete afariste janë të përcaktuara me nenin 69 të LPP. Ky fakt nuk kontestohet as nga vet parashtruesi. Njëkohësisht parashtruesi nuk ka kontestuar as përmbushjen e kriterëve në nenin 11 par. 3 nënpar. 2 dhe 3. Parashtruesi në kërkesën për rishqyrtim ka kontestuar vetëm bazën ligjore nëse dokumentet në fjalë mundën ose jo të klasifikohen si sekrete afariste. Prandaj sa i përket pretendimit të parashtruesit mund të thuhet se baza ligjore e kontestuar nga parashtruesi është konfirmuar nga dispozitat e cituara më sipër të nenit 1 par. 12 lidhur me nenin 11 par. 3 et. al. të LPP. Përndryshe kjo bazë ligjore konfirmohet edhe përmes nenit 7 par. 7.5 të RRPP ku thuhet se *"Informacionet të cilat mund të klasifikohen si informacione sekrete afariste janë: a. informacionet në lidhje me pasqyrat ekonomike dhe financiare, neni 68 i LPP; dhe b. informacionet në lidhje me mundësitë teknike dhe/ose profesionale, neni 69 i LPP"*. Në këtë mënyrë është gjetur se ky pretendim i parashtruesit është i pabazuar.

Lidhur me pretendimin e dytë (II) si provë materiale është administruar oferta e tenderuesit të rekomanduar ashtu që është gjetur se një nga operatorët e grupit të operatorëve ekonomik tenderues i cili është "Expedio" Sh.P.K. Pretendimi i parashtruesit është referuar në dilemën nëse për shkak të numrave të ndryshëm serik të çertifikatave të bizneseve që ka dorëzuar ky operator ekonomik, mund të bëhet fjalë për më shumë se një operator ekonomik dhe jo vetëm një ("Expedio" Sh.P.K). Në mesin e dokumenteve që janë dorëzuar nga tenderuesi i rekomanduar janë edhe dy (2) çertifikata të biznesit të operatorit ekonomik "Expedio" Sh.P.K të cilat kanë numra të ndryshëm serik sikurse janë lëshuar nga ARBK (MTI). Megjithatë të dy çertifikatat i referohen biznesit në fjalë me numrin e njëjtë unik identifikues i cili është 810525678. Pra në rastin konkret bëhet fjalë vetëm për një biznes me një Numër Unik Identifikues (NUI). Sa i përket dilemës së parashtruesit, duhet cekur se numrat serik që potencohen nuk i referohen biznesit (sepse biznesi identifikohet me NUI) por i referohen dokumentit në fjalë. Kjo nënkupton që ai numër (serik) është numër i evidencës në ARBK që e mbahet për dokumentet që ka lëshuar ARBK dhe fare nuk nënkupton që bëhet fjalë për më shumë se një biznes në rastin konkret. Sa i përket emrit të biznesit apo emrit tregtar që mund të ketë një biznes, kjo është çështje e rregullimit apo ndryshim/plotësimit të akteve të brendshme juridike konkretisht përmes statutit të OE. Prandaj pretendimi i parashtruesit është i pabazuar.

Lidhur me pretendimin e tretë (III) është gjetur se dokumentet që ka dorëzuar tenderuesi i rekomanduar në emër të çertifikatave ISO janë të vërtetuara nga IAF (International Accreditation Forum). Njëkohësisht është gjetur se edhe dokumentet që ka dorëzuar vet parashtruesi në emër të çertifikatave ISO janë po ashtu të vërtetuara nga IAF. Pretendimi i parashtruesit që autoriteti që ka lëshuar çertifikatat ISO duhet të jetë i regjistruar edhe si nënkontraktor me rastin e ofertimit si i tillë është pretendim paradoksal dhe i palogjikshëm. Paradoksal është për faktin se një veprim nuk e ka bërë as vet parashtruesi. Ndërsa i palogjikshëm është për shkak se në një rast të tillë, për të gjitha rastet kur kërkohen çertifikata ISO do duhej të nënkontraktohej edhe IAF (International Accreditation Forum). Prandaj pretendimi i parashtruesit është i pabazuar.

Sipas trajtimit dhe elaborimeve më lartë në këtë vendim është gjetur se parashtruesi nuk ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimet e tij. Njëkohësisht nga provat materiale të administruara është gjetur se pretendimet e parashtruesit janë tërësisht të pabazuara. Prandaj kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit është refuzuar si e pabazuar në tërësi.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.1.1. nënparagrafin a) lidhur me nenin 62 par. 62.1. nënparagrafin d) të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

Për pikën III dhe IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.2. të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 31.05.2023

Visar SHEHU



Ud. Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit
Komuna e Prishtinës

Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.